

Gazeta gjermane “Bild” në artikullin e saj të sotëm mes tjerash sjell edhe një shkresë të datës 3 shkurt nga Ambasada e Gjermanisë në Kosovë, shkresë kjo e cila i është dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Berlin dhe të cilën e ka parë “Bild”.

Sipas kësaj gazete, Ambasada gjermane paralajmëron se Kosova është para një eksodi masiv dhe se Qeverisë gjermane i “rekomandohet” që të fillohet menjëherë me dëbimet masive me ndikim të gjerë medial. Vetëm një veprim i tillë do të mund ta parandalonte ortekun e refugjatëve nga Kosova drejt vendeve të BE-së dhe më së shumti Gjermanisë, raporton Gazeta Blic.

Vetëm nga Prishtina pothuajse çdo ditë nisen nga 500 persona me autobusë drejt Evropës. Dhe kjo sjell një mesatare prej 15.000 personash në muaj. Një punëtor i Ambasadës gjermane ka shkuar në vend të ngjarjes dhe ka parë se autobusët janë plot, ka shtyrje për vende të lira dhe se trendi është duke shënuar rritje e cila do të shkojë në 25.000 deri në 30.000 kosovarë në muaj që do ta lëshojnë vendin. Kjo sjell tek shifra që vetëm për këtë vit do të pritej që Kosovën ta lëshojnë rreth 300.000 kosovarë, që shënon një të gjashtë të popullatës së Kosovës,

Përfaqësia e shtetit më të fuqishëm të BE-së në Prishtinë po kështu, sipas “Bild”, ka kërkuar që të gjithë të refuzuarit për azil të kenë me vete një dëshmi të tillë dhe se ata duhet të kthehen automatikisht në Kosovë.

Është i nevojshëm një aksion efektiv në nivel federal dhe të landeve.

Sipas raportit në fjalë, diplomatët gjermanë në Prishtinë shkruajnë “vetëm kur të fillojë kthimi masiv i kosovarëve përmes aeroplanëve qarter dhe kjo të paraqitet në media që procedurat nuk zgjasin më shumë se disa javë, gjë kjo e cila do të përhapej më tej edhe në opinion që emigrimi ilegal nuk është edhe aq i lehtë, kjo do kishte efekte.

Sipas diplomatëve gjermanë në Kosovë, është përhapur tashmë që procedura për azil në Gjermani zgjat aq shumë sa që çdo azilkërkues ka të drejtë të merr ndihma sociale dhe kjo u sjell përllogaritjen që ia vlen të kërkohet azil në këtë vend.

Sipas Ambasadës gjermane në Prishtinë, në Gjermani duhet që procedurat për azil të shkurtohen dukshëm dhe sidomos kur azilkërkuesit nga Kosova janë në pyetje.

Vitin e kaluar në Gjermani kanë kërkuar azil kryesisht pjesëtarë të pakicave- romë, ashkali dhe egjiptas.

Mirëpo tashti situata ka ndryshuar radikalisht, sepse janë pjesëtarët e shumicës shqiptare të të gjitha shtresave dhe sidomos shtresës së mesme (mësues, mjekë, punëtorë e të papunë me familje) që kanë mësyre drejt Gjermanisë, thuhet në shkresën e Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë. /Gazeta Blic/